



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1787/ Prot.

Vlorë më, 05. 10. 2023

VENDIM  
Nr 51 datë 03.10.2023

PËR

**NJË SAKTËSIM NË VENDIMIN NR. 31 TË SENATIT AKADEMIK, DATË 20.06.2023  
PËR MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT  
"BACHELOR NË INXHINIERI MEKANIKE" MIDIS UNIVERSITETIT "ISMAIL  
QEMALI", VLORE DHE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË BARIT, ITALI**

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, , të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", si dhe referuar Vendimit të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjive Detare, datë 19.06.2023 për çeljen e programit të përbashkët të studimit të Ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekanike, në bashkëpunim me Universiteti Politeknik të Barit në Itali, Senati Akademik ne mbledhjen e datës 03.10.2023,

**VENDOSI**

1. Të bëjë një saktësim në Vendimin Nr. 31, datë 20.06.2023, të Senatit Akademik, duke zëvendësuar fjalën "hapje" me "riorganizim", meqenëse aplikimi në e-albania është kërkuar për riorganizim, pra:

**Ishte**

Të miratojë propozimin e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjive Detare për hapjen e programit të përbashkët në ciklin e parë të studimit " Bachelor në Inxhinieri Mekanike", program studimi në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit, Itali,

**Bëhet**

Të miratojë propozimin e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjive Detare për riorganizimin e programit të përbashkët në Ciklin e Parë të studimit " Bachelor në Inxhinieri Mekanike", program studimi në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit, Itali,

2. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Vendimi pasi nënshkruhet nga Kryetari i Senatit hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK  
PROF.DR. ROLAND ZISI

